

## **VIDAGLIPTIN + METFORMINË**

- **Formë Doza:** Tabletë: 50/500, 50/850 mg.
- **Emri Xhenerik:** Vidagliptin + Metforminë
- **Emri tregëtar:** Galvus + Met
- **Kodi ATC:** A10BD08

### ▪ **Indikacionet dhe kriteret e përdorimit:**

Monoterapi (Diabet Mellitus Tip 2 të pakontrolluar me dietë + aktivitet fizik).

Terapi dyshe me: Vidagliptinë + Metforminë; Vidagliptinë + Insulinosekretor; Vidagliptinë + TZD

Në Diabet Mellitus tip 2 të pakontrolluar me medikamentet + dietë dhe aktivitet fizik.

Terapia treshe : Vidagliptinë + Metforminë + Insulinosekretor (dietë + aktivitet fizik).

Bashkë me Insulinë (Vidagliptinë + Metforminë + Insulinosekretor + Insulinë Bazale), kur Diabeti nuk kontrollohet me dietë + aktivitet fizik + Insulinë bazale).

### ▪ **Kundërindikacionet:**

#### **Absolute:**

- IRK e mesme dhe e rëndë me filtrim glomerular < 50 ml/min.
- Insuficiencë hepatike e rëndë.
- Shtatzani dhe laktacion.

#### **Relative:**

- Alergji nga medikamenti.
- Të bëhet vlerësimi i funksionit hepatic.

### ▪ **Efektet Anësore:**

Çrregullimet digjестive. Takohen më rrallë - dhimbje abdominale, ulje të oreksit, diarre, të vjella, dehidratim, apati, nauze dhe dobësi, rash, nazofaringit, takikardi, tremor, depresion, rënie në peshë, irritim të syve, dhimbje koke, dhimbje kockash, pankreatit, hepatit.

### ▪ **Doza dhe mënyra e përdorimit:**

50/500, 50/850 mg përdoret 2x1 tabletë çdo 12 orë, pas ushqimit. Doza maksimale 100/2000/ditë.

### ▪ **Kohëzgjatja e mjekimit:**

Sipas ecurisë së gjendjes së pacientit e vlerësuar nga mjeku i familjes dhe me konsultë të rregullt me mjekun endokrinolog. Për vlerësimin e mjekimit duhet të bëhet ndjekja me dozimin e HbA1c (**HbA1c e detyrueshme çdo 6 muaj**), duke patur si objektivi HbA1c < 7%, ose sa më pranë kësaj vlere.